




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK. Nr. 216/2019

Datë: 25 tetor 2019

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafi 1 pika 1.2, dhe neni 20 të nr.06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe nenit 5 të Rregullores 05/2016 për Rekrutim, Provimin, Emërimin dhe Riemërimin e gjyqtarëve, në mbledhjen e 225-të, të mbajtur me datë 25 tetor 2019, nxjerr këtë:

## V E N D I M

1. Emërohet Komisioni për Rishqyrtim në përbërje si vijon:
  - 1.1. Muhamet Rexha, anëtar i Këshillit Gjyqësor të Kosovës-kryetar i Komisionit;
  - 1.2. Isa Kelmendi, gjyqtar në Gjykatën Supreme të Kosovës-anëtar i Komisioni;
  - 1.3. Shqipe Qerimi, gjyqtare në Gjykatën e Apelit- anëtare e Komisionit;
  - 1.4. Shukri Sylejmani, gjyqtar në Gjykatën Supreme të Kosovës-anëtar rezervë i Komisionit;
  - 1.5. Gjimshir Galushi, anëtar i Këshillit Gjyqësor të Kosovës-anëtar rezervë i Komisioni.
2. Komisioni ka mbështetje të plotë administrative dhe profesionale nga personeli i Sekretariatit dhe Zyrës për Verifikimin dhe Vlerësimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës.
3. Obligohet drejtori i Sekretariatit të KGJK-së për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi me datë 25 tetor 2019.

## A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me datë 16 dhjetor 2018, ka shpallur konkursin publik për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatave Themelore të Republikës së Kosovës. Pas shpalljes së këtij konkursi, KGJK emëroj Komisionin për Hartimin e testit Kualifikues dhe Komisionin për Rekrutimin e Gjyqtarëve të Gjykatave Themelore, ku se shpejti pritet të filloj zhvillimi i procedurave të rekrutimit të kandidatëve që kanë aplikuar për gjyqtar.

Në këtë drejtim, Këshilli me qëllim të mbarëvajtjes së procedurave së rekrutimit të kandidatëve për gjyqtar dhe në mbështetje të nenit 5 të Rregullores 05/2016 për Rekrutim, Provimin, Emërimin dhe Riemërimin e Gjyqtarëve, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

  
Skender ÇOÇAJ  
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

*Kopje e vendimit i dërgohet:*

- Anëtarëve të Komisionit;
- Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të KGJK-së dhe
- Arkivit.